

VENDIM
Nr. 419, datë 15.5.2013

PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 shkronjat “ç”, “d” e “e” dhe 7, pika 1 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 17 e 18 të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, për vitin 2013, me vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, deri në 1 000 000 (një milion) lekë, por në asnjë rast më shumë se 50 për qind të vlerës së kostove të pranueshme. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) investime, të prekshme dhe të paprekshme, në formën e përmirësimeve teknologjike, për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;

b) shërbime këshillimore, në formën e studimeve të tregut dhe të trajnimeve;

c) pjesëmarrje, për herë të parë, në një panair ose ekspozitë jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar dhe që, gjatë procesit, i japin një vlerë të shtuar, të konsiderueshme produktit përfundimtar;

b) kanë një strategji dhe plan marketingu për zgjerimin e eksporteve;

c) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

4. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për secilin vit.

6. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

7. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Vendimi nr. 112, datë 21.2.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha